



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:005482
Datë: 17.07.2024
Numri i dokumentit: 05947455

AC-I-23-0020-A0001- A0002

Në ankesat e

Paditësi/Ankuesi

Sh R, Gjilan.- I përfaqësuar nga avokat B H, Gjilani.

Kunder

E paditura/ankuesja

NSH “ Morava e Binçes” (në likuidim) e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar Kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit dhe të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-1726 të datës 27 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit dhe e të paditurës AKP-së, refuzohen si të pazhuara.**
- 2. Reformulohet ex officio pika I e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-1726 i datës 27 dhjetor 2022, ashtu që do të jetë teksti “ Aprovohet pjesërisht si e pazhuara ankesa/kërkesa e paditësit dhe ndryshohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimi GJI037-0296 i datës 21 gusht 2013.**

3. Vërtetohet pika II, III, IV e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-1726 i datës 27 dhjetor 2022.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 13 shtator 2013, paditësi ish punëtor i NSH-së " Morava e Binçes", ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës të Kosovës (më tej " Dhoma e Posaçme") kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) nr. GJI037-0296 të datës 21 gusht 2013. Me vendimin e kundërshtuar, ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensim për tre paga të pa paguara në shumën prej 900,00 euro. Paditësi ka theksuar se në NSH-në " Morava e Binçes" nga 14 gusht 1972 deri më 25 nëntor 1972 dhe prej 05 qershor 1973 deri më 09 maj 2008 respektivisht 35 vite e 2 muaj. Ankuesi pohon se pas privatizimit të firmës në afat ligjor me shkrim e kemi njoftuar AKP-në dhe DHPGJS-në. Paditësi ka kërkuar nga gjykata që e paditura AKP të paguajë shumën prej 900.00 euro dhe 6 % kamatë prej datës 09 gusht 2010, vlerë e cila është e cekur në vendimin GJI037-0296 deri në pagesën përfundimtarë dhe ti kompensojë shpenzimet kontesti morë të gjitha në afat prej 15 ditëve. Së bashku me ankesën ai ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit, kopjen e njoftimit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies punës e datës 09 maj 2008, kopjen e vendimit GJI037-0296 e datës 21 gusht 2013, kopjen e kërkesës e datës 19 gusht 2004, kopjen e vendimit për ndihmë juridike e datës 24 shtator 2004, kopjen e padisë nga gjykata komunale e Gjilanit e datës 21 shtator 2005, kopjen e vendimit me numër 181 e datës 14 gusht 1999, kopjen e Librezës me numër 765487, njoftimin e lëshuar nga AKP e datës 16 shkurt 2011, kopjen e vendimit me nr.760/3 e datës 03 dhjetor 2003, kopjen e padisë e dorëzuar në DHPGJS-së me numër SCC-11-0098 e datës 17 mars 2011, listën e punëtorëve për kompensimin e kontributeve pensionale dhe e te ardhurave personale prej janar 2006- maj 2008 e leshur nga personi me përgjegjësi NSH me datë 19 gusht 2008.

Me 19 qershor 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se ankesa nuk përmban argumentet ligjore, në pajtim me dispozitat ligjore të Nenit 36.2.2 i shtojcës së Ligjit për AKP-në,

parashikon " elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë, kërkesë apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme", dhe në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e bashkuar parashihet se për" pagesat e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e parashkruhet për 3 vite". E paditura thekson se pala kundërshtare konstaton se vendimi që ka të bëjë me tri pagat e fundit të pa paguara GJI037-0296 është bazuar në vendimin gjyqësor C.nr.458/2009 nxjerrë nga Gjykata Komunale e Gjilanit, me datë 30 dhjetor 2011, i cili njih vetëm detyrimin e NSH-së ndaj parashtruesit si kontribute personale, jo ndonjë detyrim që ka të bëjë me paga të pa paguara për periudhën gusht 2002-2010. Nëse periudha për të cilën parashtruesi kërkon tri pagat e fundit të pa paguara ka qenë para gushtit 2002, kërkesa është parashkruar për tre vjet nga koha kur punëdhënësi nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës, bazuar në nenin 36.2.1 të Ligjit Nr.04/L-034 dhe Neni 608 të Ligjit për punë të Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr..53 të vitit 1976), më tutje AKP thekson se ankesa është e pa bazuar dhe se pala kundërshtare nuk ka ndërmarrë ndonjë hap për ndalimin e parashkrimit.

Nga të gjitha AKP propozoi që ankesa të hedhet si e pa pranueshme ose të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Me 27 dhjetor 2022, Shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-1726, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit dhe ka ndryshuar vendimin e AL, GJI037-0142 datë 11 tetor 2013. Ka Obliguar të paditurën AKP-në të paguajë paditësit Sh R në emër të kompensimit për paga të pa paguara të paguajë , shumën prej 413, 82 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore, të paguajë shumën prej 41.38 euro ndërsa, pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, është refuzuar si e pa bazuar. Ndërsa shumat e aprovuara si në pikë 2 të dipsozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Në arsyetim të Aktgjykimit thuhet se sipas nenit 42 pika 2 e ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale(të dokumentuara, fizike dhe /ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e

arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo të dorëzojnë provat e tilla atëherë vlerësohet se pala nuk ka afruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendim e tillë. Shkalla e parë, ka konstatuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi ka qenë punëtor i NSH-së "Morava e Binçes" në Gjilan por nga shkresat e lëndës gjykata vjen në përfundim se ankuesit. Në këtë çështje kontestuese ndërmjet palëve është çështja e parashtrimit të kërkesës së paditësit për kompensim për pagat e pa paguara. Shkalla e I-rë ka konstatuar se nga librezja e punës e dorëzuar si provë vërtetohet fakti se paditësi kishte krijuar marrëdhënie pune në NSH "Morava e Binçes" nga data 14 gusht 1972 deri më 25 nëntor 1972 dhe 05 qershor 1973 deri më 09 maj 2008 kohë kur edhe u privatizuar NSH-ja. Nga lista e punëtorëve për kompensimin e kontributeve pensionale dhe e të ardhurave personale prej janar 2006- maj 2008 e leshur nga personi me përgjegjësi NSH me datë 19 gusht 2008, vërtetohet fakti se ankuesi është në listë dhe figuron shuma prej 413.82 euro me çka vërtetohet edhe fakti se paditësi kishte paga të pa paguara nga NSH , në shumë prej 413.82 euro. Shkalla e parë i ka pranuar si prova relevante dhe të bazuar librezën e punës dhe listën e punëtorëve për kompensimin e kontributeve pensionale dhe te ardhurave personale prej janar 2006 - maj 2008 e lëshuar nga personi përgjegjës i NSH-së me datë 19 gusht 2008, dhe ka ardhur në përfundimtare se paditësi ka ofruar shërbime punë për NSH. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për te vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borgj.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 413.82 euro, Shkalla e parë është bazuar në listën e punëtorëve për kompensimin e kontributeve pensionale dhe te ardhurave personale prej janar 2006- maj 2008 e lëshuar nga personi përgjegjës i NSH-së me datë 19 gusht 2008. Kërkesa tjetër përtej shumes se kërkuar e qe figuron në listë pagesën e pagave nuk është mbështetur me provat e nevojshme materiale, prandaj si e tillë është refuzuar si e pa bazuar. Pretendimi i te paditurës se kërkesa e paditësit si e tera është parashkruar nuk është plotësisht i sakte. Paditësi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL me 09 korrik 2013. Shkalla e parë kishte vlerësuar se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 09 maj 2008 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës se kërkesa është parashkruar për tere detyrimin nuk është i drejte dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Më 13 janar 2023, paditësi/ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit ka pashtuar ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë C-IV-13-1726 të datës 27 dhjetor 2022. Ankuesi në ankesën e parashtruar i ka propozuar Kolegjit të Apelit që ta aprovoje ankesën si të bazuar të ti njohët e drejta në kompensimin pagave në shumë prej 900.00 euro me kamate prej 10% sepse të gjitha provat japin për te kuptuar se i nijeti ka punuar mbi 35 vite tek NSH Morava e Binçes. Ankuesi në ankesën e parashtruar thekson se ka punuar tek NSH Morava e Binçes nga 14 gusht 1972 e deri më 25 nëntor 1972 dhe nga data 09 maj 1973 e deri më 09 maj 2008 apo gjithsej 35 vite e 2 muaj i njëjti e ka njoftuar AKP-në dhe DHPGJS në lidhje me këtë fakt dhe rrjedhimisht sipas intervalit kohor të punës që e ka bere konsideron se është i pa arsyeshem fakti se ankesa është aprovuar vetëm pjesërisht.

Me 12 shkurt 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtrësë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditëses duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Më 18 janar 2023, AKP-ja parashtruar ankesë pranë Kolegjit të Apelit e të cilën e ka kundërshtuar aktgjykimin C-IV-13-1726 të datës 27 dhjetor 2022, me të cilin ka propozuar që të që të ndryshohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar në pajtim me Nenin 9.10 të Ligjit 06/L086 duke refuzuar ankesën ndaj Vendimit GJI037-0296, si të pa bazuar dhe vërtetuar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë, AKP-ja ka pohuar se Gjykata e shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontekstit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se afatet janë ngatërruar nga Gjykata. Afati i parë është ai për parashtrimin e kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta realizoj në Gjykatë e që është afati i aplikueshem i parashkrimit bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Të dy këto afate janë të ndara dhe të dallueshme dhe se të dy afatet duhet të përmbushen në mënyrë që kërkesa të pranohet. Sa i përket konstatimit të gjykatës se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në parashkrimin, AKP sqaron se ky njoftim i referohet paditësit, se ai ka

të drejtën të parashtroj kërkesën pranë AKP-së, dhe nuk i mbron të drejtat e tij me mjete tjera ligjore të cilat janë në dispozicion. Tutje AKP-ja e përsërit pretendimin e saj se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar.

Më 10 qershor 2014, Kolegji i Apelit ka lëshuar Urdhër për paditësin të parashtrojë përgjigje ndaj ankesës së AKP-së, deri në marrjen e këtij vendimi paditësi nuk ka parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e Paditësit dhe e të Paditurës / AKP-së refuzohen si të pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet, megjithatë Riformulohet ex officio pika I e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë i DHPGJS-së së C-IV-13-1726, i datës 27 dhjetor 2022.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 09 korrik 2013 e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit dhe ka kërkuar kompensimin për tre paga të pa paguara në shumën prej 900.00 euro për një periudhë të paspecifikuar nga N.SH N.H.N.I " Morava e Binçes". Kjo kërkesë është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me vendimin nr. GJI037-0296 të datës 21 gusht 2013 me arsyetimin për shkak të mungesë së provave dhe për shkak të parashkrimit sipas nenit 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar.

Shkalla e parë e DHPGJS-së e kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit dhe ka ndryshuar vendimin i autoritetit të Likuidimit të AKP-së, GJI037-

0142 datë 11 tetor 2013. Ka obliguar të padituren AKP ti paguajë ankuesit Sh R në emër të kompensimit për paga të pa paguara shumë prej 413, 82 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore, ti paguajë shumë prej 41.38 euro ndërsa, pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, refuzohet si e pa bazuar. Ndërsa shumat e aprovuara si në pikë 2 të dipsozitivit të aktgjykimit ka vendosur që të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Kundër këtij aktgjykimi kishin paraqitur ankesë paditësi dhe e paditura.

E paditura / AKP-ja nuk pajtohet me aktgjykimin e atakuar andaj edhe ka paraqitur ankesë pranë Kolegjit të Apelit dhe ka theksuar se afatet janë ngatërruar nga Gjykata. Afati i parë është ai për parashtrimin e kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta realizoj në Gjykatë e që është afati i aplikueshëm i parashkrimit bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Të dy këto afate janë të ndara dhe të dallueshme dhe se të dy afatet duhet të përmbushen në mënyrë që kërkesa të pranohet. Sa i përket konstatimit të gjykatës se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në parashkrimin, AKP sqaron se ky njoftim i referohet paditësit, se ai ka të drejtën të parashtrij kërkesën pranë AKP-së, dhe nuk i mbron të drejtat e tij me mjete tjera ligjore të cilat janë në dispozicion.

Po ashtu paditësi /ankuesi nuk pajtohet me aktgjykimin e atakuar andaj ka paraqitur ankesë pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së. Në ankesën e parashtruar thekson se ka punuar tek NSH Morava e Binçes nga 14 gusht 1972 e deri më 25 nëntor 1972 dhe nga data 09 maj 1973 e deri më 09 maj 2008 apo gjithsej 35 vite e 2 muaj i njëjti e ka njoftuar AKP-në dhe DHPGJS në lidhje me këtë fakt dhe rrjedhimisht sipas intervalit kohor të punës që e ka bërë konsideron se është i pa arsyeshëm fakti se ankesa është aprovuar vetëm pjesërisht.

Kolegji i Apelit pasi që ka vlerësuar provat dhe pretendimet nga pala paditëse dhe e paditura po ashtu edhe kundërshtimet e tyre dhe konstaton se ankesa e paditësit dhe e të paditurës janë të pa bazuar, ndërsa se Aktgjykimi i Shkalles së parë është drejtë dhe i saktë.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së ku është theksuar se bazuar në nenin 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe /ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë.

Shkalla e parë me të drejtë ka konstatuar nga lista e punëtorëve për kompensimin e kontributeve pensionale dhe e të ardhurave personale prej janar 2006- maj 2008 e leshur nga personi me përgjegjësi NSH me datë 19 gusht 2008, vërtetohet fakti se paditësi është në listë dhe figuron shuma prej 413.82 euro me çka vërtetohet edhe fakti se paditësi kishte paga të pa paguara nga NSH-ja. Kjo provë është relevante dhe bazuar edhe në librezën e punës dhe listën e punëtorëve për kompensimin e kontributeve pensionale dhe të ardhurave personale prej janar 2006 - maj 2008 e lëshuar nga personi përgjegjës i NSH-së me datë 19 gusht 2008, paditësi ka ofruar shërbime punë për NSH, prandaj me të drejtë kjo pjesë e kompensimit i është aprovuar paditësit, ndërsa pjesa tjetër përtej kësaj shume është refuzuar pasi që paditësi përveç pretendimit nuk ka bashkangjitur dëshmi për pjesën tjetër të kërkesës.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të paditurës AKP-së me ankesë se kërkesa e paditësit është parashkruar nuk është i saktë, pasi që paditësi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL me 09 korrik 2013. Shkalla me të drejtë ka vlerësuar se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 09 maj 2008 dhe kësaj pretendimi i të paditurës se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Në këtë lëndë është e qartë se AKP-ja e i ka dërguar paditësit Njoftimin për përfundimin e punësimit si rezultat i shitjes së NSH-së " Morva e Binqës" në Gjilan i cili mban dt. 09 maj 2008, në të cilën shprehimisht ceket se shumat- pagat që u janë mbetur borxh juve sipas kontratës tuaj do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se këto do të shqyrton në procedurë të Likuidimit kur të filloj

procedura dhe paditësi kishte paraqitur kërkesë me kohe tek AL, prandaj pretendimi i të paditurës në këtë aspekt është i pabazuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS me të drejtë e ka aprovuar pjesërisht shumën e kompensimit për paga të papaguara prej 413.82 euro, dhe interesin ligjor në shumë prej 41.38 euro e cila shumë do të paguhet nga ana e AKP-së, sipas prioritete të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e parë në piken I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar kur i referohet ndryshimit të vendimit të AL në vend që të përshkruaj vendimin GJI037-0296 të dt. 21 gusht 2013, të cilën paditësi e kishte ankimuar dhe në aktgjykim Shkalla e parë është referuar të njëjtit vendim të AL, ndërsa gabimisht në dispozitiv të Aktgjykimit ka shënuar vendimin e AL GJI037-0142 të dt. 11 tetor 2013, prandaj duke vërejtur këtë gabim teknik Kolegji i Apelit ex officio e riformulon vetëm piken I të dispozitivit të Aktgjykimit C-IV-13-1726 të dt. 27 dhjetor 2022, ndërsa pika e II, III dhe IV e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkalles së parë mbetet e pa prekur.

Nga këto arsye, ankesa paditësit dhe e AKP-së, refuzohen si të pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

AKP-ja /ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 100 euro me dt. 15.02.2023, ndërsa paditësi/ankuesi është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore në bazë të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 17 korrik 2024.

Mr.Sc Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____